

Kontratë Shitje Kuotash

Në Tiranë , sot me datë 23/02/2022 (dymijë e njëzet e dy) palët e mëpohtme lidhin këtë kontratë Shitje Kuotash (“Kontrata ”)

Shitësi : Shoqëria “R & T ” Sh.p.k regjistruar në Gjykatën e Rrthit Tiranë me Vendim Nr. 12590 datë 23.10.1995 ,me seli në Tiranë , Rruga “Luigj Gurakuqi ” , Pallati 89 , Shkalla A , Kati 10 me Nuis J61901094G ,përfaqësuar sipas Vendimit të Asamblesë nga Z. Renis Tershana ,I biri I Agim , lindur më 23.09.1971 me adresë Rruga “Luigj Gurakuqi ” , Pallati 89 , Shkalla A , Kati 10 , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar , identifikuar nga ID me numër H10923040R dhe numër personal 027887821 .

Blerësi : Shoqëria “Praslin Investment ” Sh.p.k , person juridik shqiptar identifikuar me numër NIPT K52113007F , me seli rruga “Nikolla Tupe ” ,nr.5 ,përfaqësuar sipas Vendimit të Asamblesë nga administratorët Z.Roland Ziu , i biri I Pilo- s lindur në Berat më 26.10.1968 , banues në Tiranë në adresën rruga “Nikolla Tupe ” ,nr.5 identifikuar me letërnjoftim elektronik G81026092A , dhe Z.Elton Bojaxhi , i biri I Aleko , lindur në Berat në datë 20.09.1982 ,me adresë Rruga “Bill Clinton ” Selitë , Tiranë person madhor me zotësi të plotë për të vepruar ,identifikuar nga karta e identitetit me numer I20920071R dhe numer personal 034473964 .

Shitësi dhe Blerësi referuar të dy sëbashku do të quhen “Palët ” .

Të përgjithshme

- 1) Palët në këtë kontratë janë ortak në “ Shoqëria Konçensionare Marina Rodon “ Sh.p.k , regjistruar me datë 27.08.2021 , identifikuar me NUISM12027005I , me zyra qendrore në adresën Tiranë , Rruga Nikolla Tuper ,nr.5 , kati 10 ,njësia administrative nr.5 me capital themeltar 1.000.000,00 Lekë (një million) (“Shoqëria ”) dhe zotërojnë secila 1 kuotë / pjesë jo të barabarta .
- 2) Shitësi zotëron 1 (një) kuotë në Shoqëri e cila përfaqëson 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë me vlerë 300.000,00 Lekë (treqind mijë) (“Kuota ”) .
- 3) Shitësi dëshiron t’I shesë Blerësit Kuotën e tij në Shoqëri . Në përfundim të transferimit të Kuotës , shitësi nuk do të jetë më ortak në Shoqëri .
- 4) Me nënshkrimin e Kontratës , Blerësi , pra Shoqëria “Praslin Investment ” shpk bëhet ortak I vetëm i Shoqërisë dhe zotëron 100 përqind të kapitalit të Shoqërisë .
- 5) Shitësi dhe Blerësi janë palë si bashkim shoqërish në “Kontratë për dhënie me koncension / partneritet public privat të portit të jahteve Marina Rodon, me nr.repertori 1188Kol dhe nr.koleksioni 237 datë 30.07.2021 (**Kontrata e Koncensionit**) ” .

Në zbatim të Kontratës së Koncensionit është themeluar dhe regjistruar Shoqëria .

Për sa më sipër palët nënshkruajnë kontratën e shitjes si më poshtë vijon :



Neni 1

Objekti

- 1.1 Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë . Shitësi I transferon nëpërmjet Kontratës , Kuotën që ai zotëron në Shoqëri , pra tek “ Shoqëria Konçensionare Marina Rodon ” sh.p.k , dhe konkretisht 1 (një) kuotë që përbën 30 % të kapitalit të Shoqërisë .
- 1.2 Menjëherë me nënshkrimin e kontratës Blerësi bëhet ortak i vetëm i Shoqërisë duke zotëruar 1 (një) kuotë që përbën 100 përqind të kapitalit të Shoqërisë duke ushtruar kështu të gjitha të drejtat e ortakut të vetëm të njohura nga legjislacioni i zbatueshëm .

Neni 2

Çmimi I Shitjes dhe pagesa

- 2.1 Çmimi I plotë I shitjes është 300.000 (treqind mijë) Lekë
- 2.2 Palët bien dakord se çmimi është paguar dhe pronësi kalon menjëherë që në ditën e lidhjes së kontratës .
- 2.3 Shitësi deklaron se Kontrata I krijon efektet ligjore me nënshkrimin e saj dhe se nuk ka asnjë kusht paraprak apo pezullues I cili të kushtëzojë kalimin e Kuotës nga Shitësi te Blerësi . Gjithashtu , Shitësi deklaron se nuk ka asnjë pretendim ndaj Blerësit kundrejt transferimit të Kuotës .

Neni 3

Gjendja financiare e “Shoqëria Konçensionare Marina Rodon “ shpk

- 3.1 Shoqëria konçensionare nuk ka detyrime ndaj administratës tatimore , doganore apo palëve të treta . Çdo detyrim që mund të lind ose mund të provohet në të ardhmen se ka lindur para lidhjes së kësaj kontrate , do të shlyhet nga ‘ Shoqëria Konçensionare Marina Rodon ‘ shpk ose nga artaku ‘ Praslin Investment ‘ shpk .
- 3.2 Shoqëria ‘R & T ‘ shpk nuk ka asnjë detyrim që lidhet me pjesëmarrjen në këtë shoqëri dhe të dyja palët deklarojnë se nuk kanë detyrime dhe të drejta ndaj njëra – tjetrës që lidhen me ‘Shoqërinë Konçensionare Marina Rodon ‘ shpk .

Neni 4

Detyrimet për Kontratën e Konçensionit

- 4.1 Shoqëria ‘Praslin Investment ‘ shpk dhe ‘Shoqëria Konçensionare Marina Rodon ‘ do të përmbushin çdo detyrim ndaj administratës tatimore , institucioneve të tjera ose subjekteve të treta dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë , nga e cila buron Kontrata e Konçensionit ose që lidhet me Kontratën e Konçensionit .



4.2 Shoqëria 'Praslin Investment' shpk dhe Shoqëria Konkensionare Marina Rodon shpk, nëse do të jetë e detyrueshme, do të njoftojë dhe marrë miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktor i Kontratës së Konkensionit, pra Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Neni 5

Mosmarrëveshjet

5.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6

Dokumentacioni

6.1 Shitësi nuk disponon asnjë dokument që lidhet me 'Shoqëria Konkensionare Marina Rodon' shpk.

Neni 7

Detyrimet e palëve dhe garanci

7.1 Shitësi :

- a) Deklaron se ka pasqyruar të dhëna të sakta ;
- b) Vendimi i Asamblesë së Shitësit për shitjen e Kuotës (pjesës) është i ligjshëm dhe i marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e Shoqërisë ;
- c) Do të kryejë çdo veprim që Blerësi të ushtrojë të drejtat si ortak i shoqërisë 'Shoqëria Konkensionare Marina Rodon' shpk dhe veprimtaria e shoqërisë konkensionare të kryhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe sipas interesave të ligjshme të Blerësit dhe të vetë shoqërisë 'Shoqëria Konkensionare Marina Rodon' shpk

7.2 Blerësi :

- a) Deklaron se ka pasqyruar të dhëna të sakta dhe garanton çfarë ka deklaruar në këtë kontratë ;
- b) Vendimi i asamblesë së Blerësit për blerjen e pjesëmarrjes është i ligjshëm dhe i marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e shoqërisë ;
- c) Do të përmbushë çdo detyrim që lidhet me shoqërinë 'Shoqëria Konkensionare Marina Rodon' Shpk dhe pranon se shitësi nuk ka asnjë detyrim që lidhet me shoqërinë 'Shoqëria Konkensionare Marina Rodon' Shpk dhe pranon se shitësi nuk ka asnjë detyrim financiar ose detyrim tjetër për të përmbushur që lidhet me shoqërinë konkensionare .

Neni 8

Legjislacioni i zbatueshëm

8.1 Kjo kontratë lidhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, sidomos Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe



legjislacioni mbi shoqëritë tregtare , koncensionit / partneritetit oublik privat , dhe regjistrit tregtar .

Neni 9

Hyrja në fuqi e Kontratës

9.1 Të gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë i fillojnë efektet nga çasti i nënshkrimit të saj nga palët .

Neni 10

Zgjidhja e Kontratës

10.1 Kontrata mund të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve ose për shkaqe të ligjshme .Palët do të zgjidhin me mirëkuptim pasojat që rrjedhin nga zgjidhja e Kontratës .

Neni 11

Komunikimet

11.1 Komunikimet do të jenë nëpërmjet postës elektronike të njoftuar nga palët ose adresave të Shoqërisë të deklaruar në Qendren Kombëtare te Biznesit .

11.2 Palët bien dakort se personat e kontaktit për secilën shoqëri janë administratorët e shoqërive përkatëse .

Neni 12

Të ndryshme

12.1 Nëse ndonjë diapozitë këtu është , ose bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme , një pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e tillë nuk I cënon dispozitat e tjera të kësaj Kontrate .Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitën sa më shpejt që të jetë e mundur me një dispozitë tjetër të vlefshme dhe të zbatueshme , përmbajtja e së cilës është e ngjashme me dispozitën e pavlefshme ose të pazbatueshme , me efekt ekonomik të përafërt .

Neni 13

Dokumentacioni bashkëlidhur

13.1 Dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kontrate bëhet pjesë e saj : i)Kopje dokument identifikimi të palëve nënshkruese , ii) ekstrakte të shitësit dhe blerësit dhe ‘Shoqërisë Koncensionare Marina Rodon’Shpk , vendimet e asamblesë të secilës shoqëri . Kjo kontratë nënshkruhet në 4 kopje me të njëjtën fuqi ligjore , ne 4 faqe secila .

Shitësi



Renis Tërshiana
Administrator

Blerësi




Roland Ziu **Elton Bojaxhi**
Administrator Administrator